


RELACIONI TEKNIK MBI VLERËSIMIN E RISKUT

Kisha e Manastirit të Shën Mërisë së Spilesë

Objekt kulti, Kategori I-rë

Fshati Tranoshishtë, Gjirokastër.



1. Hyrje	2
2. Përshkrimi i kompozimit Arkitektonik.....	2
3. Muratura.....	3
4. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese	3
5. Konkluzione	3

1. Hyrje

Ky relacion hartohet nga DRTK - Gjirokastër pas inspektimit te gjendjes me date 04.09.2024, per te verifikuar gjendjen e objektit pas projektit te hartuar para nje viti. Sic shihet nga fotot e meposhteme objekti nuk ka pasur ndryshime nga koha e hartimit te projektit. Konstruksioni, catia dhe gjithe elementet e ndertesës jane ne gjendje te qendrueshme, duke iu referuar vitit te kaluar. Per kete arsyre kerkojme rimiratimin e projektit per te gjetur mundesine e financimit si nga IKTK-ja, DRTK Gjirokaster ose nga fondet e projektit IPAR 2, per te cilat kemi aplikuar.

2. Përshkrimi i kompozimit arkitektonik

Përbëhet nga naosi i piktuar ne vitin 1634 nga Mihali (i cili duhet të jetë Mihali nga Linotopi), narteksi i piktuar në vitin 1659 dhe një portik përpëra hyrjes së narteksit në anën jugore. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë, me përmasa të brendshme $7,40 \times 6,20$ m. Kompozimi planimetrik, zgjidhja konstruktive dhe formulimi i jashtëm arkitektonik ndryshojnë shumë pak nga ato të kishës që ndodhet në fshat, gjë që, duke patur parasysh dhe kohën e njëjtë të ndërtimit, na shtyn të mendojmë se të dy kishat do të janë ndërtuar nga të njëjtët mjeshtëra. Kollonat e brendshme lidhen ndërmejtyre dhe me muret perimetrale me harqe në të dy drejtimet duke formuar bërthamën qëndrore katrore, të mbuluar me kupolë mbi tambur dhe katër krahët e kryqit, të mbuluar me qemere cilindrike. Cifti lindor i pjesëve këndor mbulohet me kësule sferike, ndërsa ai perëndimori me qemere me prerje çerekrrethore. Kisha ndriçohet nga dritaret e tamburit dhe ato të hapura në muret verior dhe jugor. Në anën perëndimore naosi lidhet me narteksin, i cili mbulohet nga një qemer gjatësor në pjesën qëndrore, i ngritur mbi dy qemere tërthore, në pjesët anësore. Hyrja nga jugu mbrohet nga një portik i hapur në tri anë me harkada, që formojnë një bërthamë katrore të mbuluar me kupolë. Kisha është e suvatuar nga jashtë, por suvatimi nuk i ka rrafshuar reliefet e krijuara në apsidë dhe në tambur. Tamburi tetëfaqësh përmban katër dritare, të alternuara me faqe të plota e të rrafshta. Muratura e tamburit përfundon me një kornizë të fuqishme, të përbërë nga tri rradhë në formë dhëmbësh sharre. Apsida pesëfaqëshe përmban nikelë vogla në pjesën e vendosur në formë dhëmbesh sharre.



3. Muratura

Kisha eshte e ndertuar rreze malit me gure te radhes ,e mbuluar me cati me rasa guri. Kisha është e suvatuar nga jashtë, por suvatimi nuk i ka rrafshuar reliefet e krijuara në apsidë dhe në tambur. Tamburi tetëfaqësh përmban katër dritare, të alternuara me faqe të plota e të rrfshta. Muratura e tamburit përfundon me një kornizë të fuqishme, të përbërë nga tri rradhë në formë dhëmbësh sharre




4. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese




Ka një kohe te konsiderueshme qe ne kete objekt nuk eshte bere ndonje rionstruksion. Si rezultat i kesaj, objekti ka problem ne qendrueshmeri, cati, ne pjesen e hyrjes dhe ne pikturat murale. Gjithashtu, ka nevoje per pastrime dhe ringritjen e një pjese te mureve rrethues. Projekti ne fjale i permbush kerkesat tobna per restaurimin e etij objekti.

5.Konkluzione

Sic shihet nga fotot e meposhteme objekti nuk ka pasur ndryshime nga koha e hartimit te projektit. Konstruksioni, catia dhe gjithe elementet e ndertesës jane ne gjendje te qendrueshme, duke iu referuar vitit te kaluar.







Ing. Vasil POLO

Vasil
Polo

Sokol
Ismaili

Digital signature by
Sokol Ismaili
Date: 2024.09.01
+02'00'

Digital signature by
Sokol Ismaili
Date: 2024.10.04
13:12:34 +02'00'

DREJTOR

Ing. Ardis DUKA

REPUBLICA E SHQIPERISE
MINISTERI I KULTURES
INSTITUTI KOMBETAR I TRASHEGINISKE
Duke i
DUKA